LIGJ
Nr. 90/2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 80/2021, "PËR REGJISTRIMIN E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 80/2021, "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", i ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Kudo në përmbajtjen e ligjit:
a) emërtimi "Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë" zëvendësohet me emërtimin "Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë", sipas kontekstit gramatikor përkatës;
b) fjala "fillestar" zëvendësohet me fjalët "për herë të parë".

Neni 2

Në nenin 3, pikat 10 dhe 11, në nenin 6, pika 1, në nenin 10, në nenin 11, pika 1, në titullin e seksionit IV, në nenin 33, pika 2, si dhe në nenin 35, pika 1, fjalët "regjistrim tjetër" zëvendësohen me fjalët "regjistrim i ndryshimeve të të dhënave", sipas kontekstit gramatikor përkatës.

Neni 3

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton procedurat e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse, sipas legjislacionit në fuqi, që përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse, si dhe rregullat për mbajtjen e regjistrit të tyre.".

Neni 4

Pika 9 e nenit 3 ndryshohet si më poshtë:
"9. "Regjistrimi për herë të parë" është regjistrimi i organizatave jofitimprurëse pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me qëllim fitimin e personalitetit juridik.".

Neni 5

Titulli i seksionit II të kreut II ndryshohet si më poshtë:
"Regjistrimi i organizatave jofitimprurëse, rregullat e emërimit, personat e autorizuar dhe forma e akteve shoqëruese".

Neni 6

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 8
Regjistrimi i organizatës jofitimprurëse

Kërkesa për regjistrimin për herë të parë, si dhe kërkesa për regjistrimin e ndryshimeve të të dhënave paraqitet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, sipas legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse.".

Neni 7

Titulli i nenit 17 ndryshohet si më poshtë:
"Regjistrimi i ndryshimeve të të dhënave".

Neni 8

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 25
Vendimmarrja e gjyqtarit

Vendimi për regjistrimin për herë të parë të organizatave jofitimprurëse ose për regjistrimin e ndryshimeve të të dhënave, si dhe vendimi për çregjistrimin e tyre merret nga një gjyqtar i seksionit tregtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj.".

Neni 9

Neni 26 shfuqizohet.

Neni 10

Titulli i nenit 30 ndryshohet si më poshtë:
"Përjashtimi i gjyqtarit".

Neni 11

Pika 5 e nenit 33 ndryshohet si më poshtë:
"5. Kundër vendimit të gjyqtarit për mospranimin e kërkesës për regjistrimin për herë të parë të organizatave jofitimprurëse ose kërkesës për ndryshimin e të dhënave mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve punë nga njoftimi i vendimit.".

Neni 12

Neni 34 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 34

Përmbajtja e vendimit të regjistrimit

Vendimi i gjyqtarit për regjistrimin për herë të parë të organizatave jofitimprurëse ose për regjistrimin e ndryshimeve të të dhënave duhet të përmbajë në mënyrë të plotë çështjet që duhet të pasqyrohen në regjistrin elektronik.”.

Neni 13

Në pikën 1 të nenit 39 fjalët “brenda afatit të përcaktuar në këtë ligj për regjistrimin fillestar” hiqen.

Neni 14

Pas pikës 1 të nenit 49 shtohen pikat 1/1, 1/2, 1/3 dhe 1/4 me këtë përmbajtje:

“1/1. Deklarimi në regjistrin elektronik i të dhënave të pavërteta, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

1/2. Moskryerja e detyrimit për regjistrimin e ndryshimeve të të dhënave përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

1/3. Gjykata përpara marrjes së vendimit për caktimin e masës administrative, sipas pikave 1/1 dhe 1/2 të këtij neni, urdhëron palët të paraqesin kërkesën për regjistrimin e ndryshimit të të dhënave ose për kryerjen e korrigjimeve të tyre. Në rast se brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit, organizata jofitimprurëse ose personat e autorizuar nuk paraqesin kërkesën përkatëse, gjykata vendos gjobë sipas përcaktimeve të këtij neni.

1/4. Ndaj vendimit për caktimin e gjobës mund të paraqitet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.”.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren zyrtare.

Miratuar në datën 12.12.2025.

Shpallur me dekretin nr. 4, datë 7.1.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.